



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSTINA KAÇANIK



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

Data	11.03-26	Vendi	KAÇANIK
Nr. org.		Numri	
	01		370/01-6027-1.

KONTRATA PËR SHËRBIME

Komuna e Kaçanikut (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), i përfaqësuar nga **Izahir Kuka** –

U.d. Menaxher i prokurimit; në njëjërë anë dhe "**AS-TECH**" Shpk nga **Llpijani** (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), i përfaqësuar nga i autorizuari **Valdet Sadiku** me nr personal 1014723300 ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

Mirmbajtja dhe servisimi i Gjeneratorëve

me numër Identifikues : 652-26-383-2-3-6

KA652/26/009/236

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të **Mirmbajtja dhe servisimi i Gjeneratorëve**

1.2 Kontrata hynë në fuqi **12.03.2026**.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se **12 muaj** nga data e nënshkrimit të kontratës

1.4 Vendi **Komuna Kaçanik**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë **DDP¹** (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë **LPP-04/L-042**. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **1,729.00 €**; me fjalë (Njëmijëeshtatëqindënjëzetënjëntëeuro çmime per njësi), ndërsa vlera e parashikuar e kontratës është **9,500 me fjalë nëntëmijëepesëqindëeuro**

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).

Neni 4 Pagesat

4.1 PAGESA DO TË BËHET NË EURO NË LLOGARIN BANKARE).

Autoriteti Kontraktues do të paguaj OE dhe atë pas pranimit të punëve nga na e menagjerit të projektit si dhe komisionit për pranim të punëve

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të *Shërbimeve apo pjeseve të ndrruara*.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin *[t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [të kryej ndonjë ose të gjitha punët]* brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *[furnizimeve] [punëve] [shërbimeve]* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e

caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në gjykatën komunale në Kaçanik në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dorëgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [Shqip] [Serbisht] [Anglisht] ² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Valdet Sadiku	Emri:	Izahir Kuka
Pozita:	I autorizuar	Pozita:	U.d. Menagjerit të Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	11.03.2026	Data:	11.03.2026
Vula:		Vula:	

PARAMASA PËR MIRËMBAJTJE DHE SERVICIM TË GJENERATORËVE

NR	EMERTIMI I ARTIKULLIT	NJ.MATSE	SASIA	Çmimi	TOTALI
1	Furnizimi , transporti dhe ndërrimi i vajit të motorrit për gjenerator	L	1	14	14
2	Furnizimi , transporti ndërrimi dhe montimi i filterit të ajrërit për gjenerator	C	1	55	55
3	Furnizimi , transporti , ndërrimi dhe montimi i filterit të naftës.	C	1	55	55
4	Furnizimi , transporti , ndërrimi dhe montimi i filterit të vajit.	C	1	55	55
5	Furnizimi , transporti , ndërrimi dhe montimi i bateris për gjenerator.	C	1	210	210
6	Furnizimi , transporti dhe montimi i ventilit jokthyes.	C	1	25	25
7	Furnizimi , transporti dhe montimi i papuqes Cu 50mm.	C	1	45	45
8	Furnizimi , transporti dhe ndërrimi i antifrizit 100%	L	1	5	5
9	Furnizimi , transporti dhe montimi i starterit.	C	1	340	340
10	Furnizimi , transporti dhe montimi i pompes me presion të lartë (bosh)	C	1	250	250
11	Furnizimi , transporti dhe montimi i AC pompes.	C	1	140	140
12	Furnizimi , transporti dhe montimi i ftohesit.	C	1	45	45
13	Furnizimi , transporti dhe montimi i nxemesit.	C	1	55	55
14	Furnizimi , transporti dhe montimi i termostatit	C	1	55	55
15	Furnizimi , transporti dhe montimi i rrypit.	C	1	25	25
16	Furnizimi , transportit dhe montimi i injektorit.	C	1	35	35
17	Furnizimi , transportit dhe montimi i alternatorit.	C	1	60	60
18	Furnizimi , transporti dhe montimi i dizneve të motorrit	C	1	35	35

19	Furnizimi , transporti dhe montimi i kushinetave rrshqitese.	C	1	45	45
20	Furnizimi , transporti dhe montimi i kushinetave fluturuese.	C	1	45	45
21	Furnizimi , transporti dhe montimi i semeringave	C	1	55	55
22	Furnizimi , transporti dhe montimi i ventiliave te kokes se motorit	C	1	25	25
23	Furnizimi , transporti dhe montimi i fluturave per ftohjen e radiatorit.	C	1	55	55
TOTALI					1,729.00



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kaçaniku
Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

Kryetari i Komunës
01 Nr. 370/01-6027
Kaçanik, 16.03.2026

Në bazë Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 të
Rregullores 001/2022 Për Prokurimi Publik nenit 70 , Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
PËR EMËRIMIN E MENAXHERIT TË PROJEKTIT

I. Me këtë vendim emërohet menaxher i projektit **Hasan Zhakru** në projektin: **Mirëmbajtja dhe servisimi i gjeneratorëve** . Në bazë të kontratës **01NR.370/01-6027** të datës **11.03.2026**

II. Menaxheri i projektit do të jetë përgjegjës për menaxhimin e projektit të lartpërmendur, do të raportoj me shkrim ZKA, Zyren e Prokurimit, **DKA** mbi realizimin e punëve në teren.

III. Sipas këtij vendimi Menaxherët e projektit do të jenë të angazhuar në procesin e implementimit të projektit, bazuar në përgjegjësit sipas LPP-se dhe Rregullores së Prokurimit Publik.

IV. Me këtë vendim të njoftohet: Menaxheri, Zyra e prokurimit , OE dhe **DKA**

